



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR VLORE

Nr 488/57 Rregj
Date regj 21.06.2013

Nr 366 Vendimit
Data 08.07.2014

V E N D I M
“Ne Emer te Republikes”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, e perbere nga:

GJYQTAR/KR - ARQILE BASHO
GJYQTAR - ALBERT SPIRO
GJYQTAR - MIRELA MISHGJONI

Asistuar prej sekretares Luljeta Kollombo,
Me pjesmarrjen e prokurorit Klodian Braho,
Ne gjykate, sot ne date 08.07.2014 shqyrtoi ne seance gjyqesore publike
ceshtjen penale me Nr.488/57 Regj, date 21.06.2013 ne ngarkim te:

I PANDEHUR: 1. **Mihail Rrapaj**, i biri i Muharrem dhe Kate, lindur më
02.05.1957, i lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, lagje
“Kushtrim”, Rruga “Mehmet Pashë Dërrala”, banesë private, i
martuar, me arsim 8-vjecar, me shtetësi shqiptare, i hetuar dhe
gjykuar me masën e sigurimit “arrest në burg”, në mungesë.

I akuzuar: Per veprën penale “*Pastrimi i produkteve te veprës penale*”

Të parashikuar: Nga neni 287/1, pikat (a), (b) dhe (dh) të K.Penal, (sipas
përmbajtjes së saj para ndryshimeve të ligjit nr.23/2012.)

2. **Xhuljeta Anastasiadhi**, e bija e Myslim dhe Barije, dt/lindja
20.01.1950, lindur dhe banuese në Vlorë, lagje “24 Maji”,
Pallati Nr.1388, Sh 1, Kati 4, gjëndja familjare e ve, me arsim
të lartë, me shtetësi Shqiptare, e hetuar prej datës 27.05.2013
me masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.

E akuzuar : Per kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i dokumentave*”, më
shumë se një herë,

Të parashikuar: Nga neni 186/2 i K.Penal.

Ne përfundim të shqyrtimit gjyqesor të ceshtjes palet kerkuan:

Prokurori

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Mihail Rrapaj për kryerjen e veprës penale "*pastrimi i produkteve të veprës penale*" të parashikuar nga neni 287/1, pikat (a), (b) dhe (dh) të K.Penal, sipas përmbajtjes së saj para ndryshimeve të ligjit nr.23/2012 dhe denimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 6 (gjashtë) vjet burgim.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurës Xhuljeta Anastasiadhi për kryerjen e veprës penale "*falsifikimi i dokumentave*", më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal dhe denimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
3. Në bazë të nenit 391/1 të K.Pr.Penale, të deklarohen si të falsifikuara dokumentat e sekuestruara të mëposhtme;
 - a. Vendimi nr.298 datë 15.10.1996 të ish- K.K.K.P Vlorë, bashkëlidhur planimetria e vendosjes së pronës në emër të këtij komisioni, mbi bazën e të cilave janë rregjistruar pasurite e paluajtshme nr.410/5, zona kadastrale, si dhe ajo me nr.1316 nr.410/3, zona kadastrale nr.2142;
 - b. Vendim nr.75 datë 21.03.1995 të K.K.K.P, Vlorë, planimetria përkatëse e truallit që shoqëron këtë vendim, mbi bazën e të cilit është rregjistruar pasuria e paluajtshme nr.19/169, zona kadastrale nr.8604;
 - c. Prokurë e përgjithshme nr.360 Rep dhe nr.223 Kol, datë 12.02.2008 në emër të Jorgji Anastasiadhi;
 - d. Kontratë shitje nr.2500 Rep dhe nr.9491 Kol, datë 24.06.2009, e lidhur midis shtetasve Xhuljeta Anastasiadhi dhe Agim Allushi, për shitjen e pasurisë nr.19/169, zona kadastrale nr.8604.
4. Në bazë të nenit 36/b të Kodit Penal, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit, produktet e veprës penale të falsifikimit të dokumentave, të cilat janë nën masën e sigurimit të sekuestros preventive, dhe konkretisht;

- a. Pasuria me nr.410/5, zona kadastrale nr.1316, e llojit kullotë, me sipërfaqe 87.634 m², e ndodhur në fshatin Bunavi, Komuna Shushicë, Vlorë;
- b. Pasuria me nr.410/3, zona kadastrale nr.2142, e llojit kullotë, me sipërfaqe 12.366 m², e ndodhur në fshatin Kërkovë, Komuna Qëndër Vlorë;
- c. Pasuria me nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, e llojit truall, me sipërfaqe prej 2.185 m², e ndodhur në lagjen “24 Maji” në Vlorë.
5. Në bazë të nenit 190/1, gërma (ç) të K.Pr.Penale, lidhur me dokumentet e tjera të sekuestruara, të përshkruara në urdhërin e Prokurorit datë 17.06.2013 për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor, t’ju kthehen personave që iu janë sekuestruar sipas proces verbaleve përkatëse të sekeustrimit.

Shpenzimet proceduriale në hetim, në masën 36.000 lekë, si dhe ato gjyqësore, t’ju ngarkohen të pandehurve

Av. Edmond Dema: - Deklarimin te pafajshem te te pandehurit per shkak se nuk provohet qe vepra penale te jete kryer prej tij.

I pandehuri : - ne mungese, deklaruar mungesa.

Av. Ervin Baca: -Deklarimin te pafajshme te te pandehures Xhuljeta Anastasiadhi pasi nuk jane konsumuar elementet e vepres penale te parashikuar nga neni 186 te K.Penal dhe per me teper nga paragrafi i dyte. Ne cdo rast gjykata duhet te mbaje parasysh moshen 65 vjecare te te pandehures.

E pandehura: Jam dakort me theniet e avokatit dhe kerkoj pafajesi.

Gjykata pasi degjoi palet, shqyrtoi aktet e fashikullit hetimor dhe ceshtjen ne teresi,

VERE N

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore ka parashtruar kerkesen per gjykimin e Procedimit penal Nr.588, dt 24.06.2012, ne ngarkim te te pandehurit Mikail Rrapaj, akuzuar per kryerjen e vepres penale te “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashkuar nga neni 287/1, pikat “a”, “b”, dhe “dh” (sipas përmbajtjes së saj para ndryshimeve të ligjit nr.23/2012.) te K.Penal dhe ne ngarkim te te pandehures Xhuljeta Anastasiadhi, te akuzuar per kryerjen e

vepres penale te "Fallsifikimit te dokumenteve", me shume se njehere, parashikuar nga neni 186/2 te K.Penal.

Nga shqyrtimi gjyqesor i ceshtjes rezultoi se:

I. Në Z.Rr.P.P Vlorë është regjistruar në rregjistrin hipotekor, në numërin 50, datë 20.05.2005, një sipërfaqe prej 10 ha kullotë e ndodhur në Bunavi, Vlorë, në emër të Kate Rrapaj, nenes se te pandehurit Mikail Rrapaj. Ky rregjistrim është kryer mbi bazën e aplikimit të datës 18.04.2005, në emër të Kate Rrapaj.

Nga ekspertimi grafik i kryer në këtë rast rezulton se emri, mbiemëri dhe nënshkrimi të ndodhur në këtë aplikim nuk janë shkruar nga vetë shtetasja Kate Rrapaj. Nderkohe me Aktin e ekspertimit grafik te aplikimit dhe me provat e tjera te ceshtjes nuk provohet se nga kush eshte perpiluar dhe parashtruar aplikimi per rregjistrim.

Në vitin 2007 pasuria e rregjistruar në rregjistrin hipotekor me nr 50 është ndarë në dy pasuri, I- Pasuria me nr.410/5, zona kadastrale nr.1316 dhe II- Pasuria me nr.410/3, zona kadastrale nr.2142 – fakt qe provohet me aktet e Zyres se RrPP Vlore mbi keto pasuri.

Titulli i pronësisë mbi bazën e të cilët janë regjistruar pasuritë e mësipërme është vendimi me nr.298, datë 15.10.1996, i ish-K.K.K.P Vlorë. Në këtë vendim është përshkruar se dosja ka numërin 249, datë 15.04.1996. Sipas permbajtjes se ketij vendimi rezulton se është vendosur të njihet pronare Znj.Kate Rrapaj mbi një sipërfaqe kullote prej 17 ha në fshatin Bunavi, Vlorë, si dhe ti kthehet në natyrë sipërfaqeja prej 10 ha tokë kullotë në fshatin Bunavi, Vlorë. Vendimi ka emrin e kryetarit Vladimir Balla, nënshkrimin poshtë emrit të tij, si dhe vulën e komisionit.

Nga verifikimet e kryera, te dokumentuara ne aktet perkatese, në Agjensinë e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Tiranë, rezulton se prane ish Komisionit te K.K.Pronave Vlore është celur dosja me nr.249 e vitit 1996 me kërkues Kate Rrapaj. Nga aktet e ndodhura në kete dosje rezulton se me Vendimin nr.806, datë 29.10.2002 të ish-K.K.K Pronave ish pronarëve Vlorë, është vendosur "Mbyllja e procedimit duke mos njohur pronar Kate Rrapaj", me arsyetimin se dokumentacioni i kësaj dosje nuk është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit. Shtetasja Kate Rrapaj rezulton që të ketë paraqitur kërkesën në ish-

K.K.K.P Vlorë për kthimin e pronave në fshatin Bunavi, rezulton që të jetë celur dosja nr.249 e vitit 1996, por ish-Komisioni i K.K.P Vlorë, me vendimin nr.806 datë 29.10.2002 ka vendosur mbylljen e procedimit lidhur me kërkesën e shtetasës Kate Rrapaj duke mosnjohur pronar shtetasen Kate Rrapaj.

Me shkresën nr.3243/1 prot dt.05.10.2012 të Agjensisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë, është konfirmuar fakti se nga verifikimet e kryera në arkivën e këtij institucioni nuk është bërë i mundur evidentimi i ndonjë vendimi të ish-K.K.K.P Vlorë, me nr.298 datë 15.10.1996.

Me Aktin e Ekspertimit teknik per ekspertimin e Vendimit Nr 298, dt 15.10.1996 te K.K.K.Pronave Vlore, datë 05.11.2012, është arritur në konkluzionin se vendimi në fjalë është i falsifikuar nga ana teknike, përmbajtja e vendimit është marrë me mënyrën e fotokopjes, nënshkrimi në emër të Vladimir Balla është kryer me mjet shkruar, ndërsa shenja e vulës në emër të K.K.K.Pronave është e vizatuar me dorë.

Si konkluzion, vendimi nr.298 datë 15.10.1996 të ish- K.K.K.P Vlorë, në bazë të të cilit janë rregjistruar në emër të shtetasës Kate Rrapaj pasuritë me nr.410/3, zona kadastrale nr.2142 si dhe nr.410/5, zona kadastrale nr.1316, është një vendim tërësisht i falsifikuar dhe me përmbajtje të rreme.

Rezultojne te provuara edhe disa rrethana të tjera, ekzistenca e të cilave provon tej cdo dyshimi se vendimi nr.298 datë 15.10.1996 të ish- K.K.K.P Vlorë është i falsifikuar, të cilat po i shpjegojmë si më poshtë;

Së pari, dosja nr.249 është celur në bazë të kërkesës së shtetasës Kate Rrapaj, e cila ndodhet në AKKP Tiranë dhe **mban datën 14.11.1996**, ndërsa vendimi nr.298 datë 15.10.1996 të ish- K.K.K.P Vlorë, **mban datën 15.10.1996**, pra rreth një muaj para se subjekti të bënte kërkesë, cka provon se vendimi nuk lidhe dhe nuk eshte pasoje e ndonje kerkese ne Komisionin e K.K.Pronave.

Së dytë, shtetasja Kate Rrapaj ka shpjeguar në kallëzimin penal se pasuritë për të cilat ka paraqitur kallëzimin penal, i ka përfutuar në cilësinë e trashëgimtares së shtetasit Avdul Hasani (Avdulaj), duke përfutuar të drejtën e kompesimit të disa pronave. Ndërsa në vendimin nr.298 datë 15.10.1996, nuk bëhet fjalë për

kompesim prone, por është parashikuar kthimi i një sipërfaqe prej 10 ha, të ndodhur në Bunavi, Vlorë. Po kështu, rezulton se me Vendimin për leshimin e deshmise trashëgimore për trashëgimlënesin Avdul Hasanaj, se shtetasja Kate Rrapaj është njohur si trashëgimtare e shtetasit Avdul Hasanaj, i cili ka vdekur më datë 20.09.1943, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr.330 datë 06.04.1999, pra pas më shumë se tre vjet nga data e vendimit të komisionit për kthimin e pronave. Ky vendim gjyqësor ndodhet i depozituar edhe në dosjen nr.249 të vitit 1996, për të cilin është vendosur mosnjohja pronar e kërkujeses. Kjo provon faktin se nëse Vendimi Nr 298 datë 15.10.1996 do të ishte rrjedhojë e kërkeses në Komision, ai do të ishte shprehur për të gjithë trashëgimtarët dhe jo vetëm për trashëgimtarën Kate Rrapaj.

Së treti, në vendimin nr.298 datë 15.10.1996 në asnjë moment të përmbajtjes së tij nuk përmendet njohja pronar e subjektit të shpronësuar Avdul Hasanaj, prej të cilit kallëzuesja pretendon se ka trashëguar pronat, në asnjë moment nuk përmendet ndonjë dokument konkret në të cilin është bazuar komisioni për dhënien e vendimit.

Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton që të jetë njohur pronar vetë shtetasja Kate Rrapaj, si dhe ti jetë kthyer sipërfaqeja prej 10 ha, e ndodhur në Bunavi, shtetases Kate Rrapaj dhe jo subjektit të shpronësuar Avdul Hasanaj.

Shtetasja Kate Rrapaj, sipas aktit të lindjes, ka lindur më datë 14.07.1936 dhe në vitin 1944 ka qënë vetëm tetë vjece, fakt që provon se ajo nuk mund të kishte pasuri të rregjistruar në emër të saj. Ndërkohë që me vendimin nr.298 datë 15.10.1996 është njohur si pronare dhe se ka pasur në pronësi sipërfaqen prej 10 ha. Edhe pasuria në fjalë është rregjistruar në Z.Rr.P.P Vlorë vetëm në emër të shtetases Kate Rrapaj dhe jo në emër të të gjithë trashëgimtarëve ligjore të shtetasit Avdul Hasanaj.

Kështu që, edhe në këtë moment vendimi nr.298 datë 15.10.1996 vjen në kundërshtim me të gjitha provat e tjera, madje edhe me vetë shpjegimet e kallëzueses Kate Rrapaj, e cila ka shpjeguar se ka qënë pronar shtetasi Avdul Hasanaj, dhe se pronat i ka të trashëguara nga ky i fundit.

Së katërti, nga të gjithë dokumentat e administruara nuk rezulton ndonjë akt shkresor që të provojë pronësinë mbi ndonjë pronë të Avdul Hasanaj. Po kështu, nuk ekziston as edhe ndonjë vendim gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik të ekzistencës së pronësisë të ish pronarit të pretenduar Avdul Hasanaj, si dhe

vëndndodhjen dhe kufijtë e pronës së pretenduar, vendim ky i cili në praktikat e komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronave duhet që normalisht të ekzistonte.

Së pesti, vendimi nr.298 datë 15.10.1996 është bazuar në ligjin nr.7686 datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish pronarëve". Objekt i ligjit në fjalë ka qënë vetëm "toka truall" dhe komisionet përkatëse në këtë kohë kanë pasur objekt të veprimtarisë së tyre kthimin e tokës truall. Ndërsa, në rastin konkret, në vendimin nr.298 datë 15.10.1996 është parashikuar që i kthehet pronarit Kate Rrapaj "sipërfaqeja tokë kullotë prej 10 ha në fshatin Bunavi, Vlorë". Edhe në Z.Rr.P.P Vlorë pasuritë me nr.410/3, zona kadastrale nr.2142 si dhe me nr.410/5, zona kadastrale nr.1316, janë rregjistruar si pasuri e llojit "kullotë".

Duke i vlerësuar të gjitha këto rrethana në tërësinë e tyre, burimet e provave ku ato bazohen, provohet plotësisht dhe tej cdo dyshimi se vendimi nr.298 datë 15.10.1996 i K.K.K.P, Vlorë, në bazë të të cilit janë rregjistruar në emër të shtetases Kate Rrapaj në Z.Rr.P.P Vlorë pasuritë me nr.410/3, zona kadastrale nr.2142 si dhe me nr.410/5, zona kadastrale nr.1316, është tërësisht i falsifikuar.

Nga këqyrja e dokumentave të kryera në zyrën e noteres, nga permbajtja e tyre, rezulton e provuar se është lidhur Kontrata e Shitjes me nr.4397 Rep dhe nr.1905 Kol, e datës 25.11.2009, e lidhur midis shtetases Kate Rrapaj dhe shtetasit Dhimitër Kondakciu, për shitjen e pasurisë nr.410/3, zona kadastrale nr.2142, e llojit kullotë, me sipërfaqe 12.366 m², e cila është shitur me cmimin 2.630.248 lekë, si dhe është lidhur Kontrata e Shitjes nr.4398 Rep, nr.1906 Kol, e datës 25.11.2009, e lidhur me midis shtetases Kate Rrapaj dhe Dhimitër Kondakciu, për shitjen e pasurisë me nr.410/5, zona kadastrale nr.1316, e llojit kullotë, me sipërfaqe 87.634 m², e cila është shitur me cmimin 12.075.965 lekë. Nga përmbajtja e të dy kontratave të mësipërme ka rezultuar se vlera e shitjes së kontratave është likujduar nga palët në kontratë jashtë zyrës noteriale.

Në dosjen e kësaj pasurie ndodhet edhe një plan rievimi që është përgatitur në muajin tetor të vitit 2006, nga topografi Manol Mertiri.

Në dosjen e pasurisë së mësipërme ndodhet edhe një vërtetim i Komunës Shushicë, ku dhe ndodhet prona, nënshkruar nga Kryetari i Komunës Shushicë.

Nga shqyrtimi gjyqësor, vecanerisht me deshmime e deshmitarit Manol Mertiri, rezultoi e provuar se këto dokumenta janë kërkuar për tu përgatitur nga i pandehuri Mihail Rrapaj.

Nga ekspertimi i kryer nënshkrimit në emër të Kate Rrapaj në aplikimin në Z.Rr.P.P Vlorë për rregjistrimin në vitin 2005, rezulton se shkrimi i emrit, mbiemrit dhe nënshkrimi i Kate Rrapaj nuk është shkruar prej saj, rrethanë kjo që konfirmon faktin se shtetasja Kate Rrapaj nuk ka kryer veprime vetë të drejtëpërdrejta për përdorimin e vendimit të falsifikuar dhe rregjistrimin e pasurisë.

Duke u nisur nga rrethanat e mësipërme, rezulton se veprimet lidhur me përgatitjen e dokumentacionit si dhe lidhur me rregjistrimin e pasurive të mësipërme në Z.Rr.P.P Vlorë janë kryer nga i pandehuri Mihail Rrapaj.

Po kështu, ky shtetas rezulton se ka shoqëruar shtetasen Kate Rrapaj në zyrën e noteres ditën që janë lidhur kontratat e shitjes së pasurive të mësipërme, se ai ka poseduar dokumentat e pronësisë, dhe se ka ndërmjetësuar për shitjen e këtyre pasurive tek shtetasi Dhimitër Kondakciu.

Nga kontrolli i kryer në banesën e të pandehurit Mihail Rrapaj ka rezultuar se në banesën e tij janë gjetur kopje origjinale të vërtetimit hipotekor të pasurisë në emër të Kate Rrapaj, si dhe kopje të letërnjoftimit të vjetër të kësaj shtetaseje, e njëjtte si ajo e bashkëngjitur kontratave të shitjes. Është gjetur gjithashtu në banesën e të pandehurit edhe kopje e planvendosjes së pasurisë si ajo që është administruar në Z.Rr.P.P Vlorë.

Po kështu, nga verifikimi i kryer në bankat e nivelit të dytë nuk ka rezultuar që të jëtë kaluar ndonjë shumë të hollash nga Dhimitër Kondakciu te Kate Rrapaj apo që kjo e fundit të disponojë ndonjë llogari bankare me ndonjë shumë të hollash e njëjtë apo e përafërt me shumën e përshkruar në kontratën e shitjes së pasurive.

Shtetasja Kate Rrapaj ka paraqitur kallëzim penal, midis të tjerave, edhe për djalin e saj Mihail Rrapaj, duke pretenduar se është mashtruar nga ky person duke i shitur pasuritë e rregjistruara në emër të saj.

Në vlerësim të të gjitha këtyre rrethanave, rezulton e provuar se i pandehuri Mihail Rrapaj, duke përdorur shtetasen Kate Rrapaj, ka shitur dhe tjetërsuar te shtetasi Dhimitër Kondakciu pasurinë e paluajtshme me sipërfaqe 10 ha, të rregjistruar mbi bazën e dokumentave të falsifikuara – konkretisht te Vendimit Nr 298, dt 15.10.1996 te K.K.K.Pronave Vlorë, fakt për të cilin ky i pandehur ka pasur tërësisht dijeni. Nga te gjitha veprimet hetimore te kryera dhe te paraqshtruara si prova ne gjykim, organi i akuzes nuk ka mundur te provoje falsifikimin e dokuentave nga vete i pandehuri dhe nuk ka ngritur ndaj tij akuzen per vepren penale te parashikuar nga neni 186 te K.Penal.

Ne keto rrethana Prokuroria ka ngritur akuzen per kryerjen e vepres penale te parashikuar nga neni 278/1 te K.Penal.

II. Nga provat qe lidhen me veprimet hetimore te kryera per identifikimin e pasurive që disponohen nga i pandehuri Mihail Rrapaj, rezulton se nuk rezultojne pasuri te rregjistruara ne emer te te pandehurit. Rezulton e provuar se shtetasja Aneta Rrapaj, bashkëshortja e të pandehurit Mihail Rrapaj, me Kontratën nr.1073 Rep, nr.514 Kol, datë 05.04.2010, pra pesë muaj nga shitja e dy pasurive ne emer të Kate Rrapaj, ka blerë nga shtetasi Agim Allushi një sipërfaqe trualli të ndodhur në lagjen “24 Maji” në Vlorë, me sipërfaqe 2.168 m², me numër pasurie 19/169, zona kadastrale nr.8604, me cmimin 10.000.000 lekë. Ndërkohë, rezulton e provuar me kontraten perkatese te shitjes se kjo sipërfaqe trualli ka qene e blere nga shitesi Agim Allushi më datë 24.06.2009 për cmimin 21.680.000 lekë.

Vihet re se në këtë rast pasuria është blere nga shtetasi Agim Allushi më datë 24.06.2009 dhe është shitur prej tij më datë 05.04.2010 me më pak se gjysmën e cmimit që është blerë kjo pasuri.

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se shtetasi Agim Allushi e njeh të pandehurin Mihail Rrapaj, se është i afërm i tij, ka biseduar me Mihailin lidhur me kontratën por sipas tij kontrata është bërë në emër të Anetës pasi Mihaili ka pasur disa probleme shëndetësore. Lidhur me shumën për shitjen e kësaj pasurie shtetasi Agim Allushi ka shpjeguar se i është dorëzuar në dorë nga shtetasja Aneta Rrapaj.

Për pasurinë me nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, shtetasja Aneta Rrapaj ka lidhur dy kontrata investim-sipërmarrje për ndërtim pallati. Në kontratën investim-sipërmarrje për ndërtim pallati, nr.3197 Rep, nr.1643 Kol, të datës 06.09.2010, të lidhur midis shtetasës Aneta Rrapaj dhe shoqërisë "M&G" sh.p.k, është parashikuar që shtetasja Aneta Rrapaj vë në dispozicion të sipërmarrësit të mësipërm sipërfaqen e truallit të ndodhur në lagjen "24 Maji" në Vlorë, me sipërfaqe 2.168 m²; me numër pasurie 19/169, zona kadastrale nr.8604, me qëllim kryejen e një ndërtimi shumëkatësh, dhe se pjesët takuese të pronarit do të caktohen me një marrëveshje të mëpasëshme, pas zbardhjes së projektit të ndërtimit dhe miratimit të lejës së ndërtimit.

Ndërsa, me kontratën investim-sipërmarrje për ndërtim pallati, nr.3997 Rep, nr.2011 Kol, të datës 09.11.2010, të lidhur midis shtetasës Aneta Rrapaj dhe shoqërisë "M&G" sh.p.k dhe "Bakaj" sh.p.k, janë specifikuar edhe pjesët takuese të pronarit të truallit në ndërtimin që do të kryhej, ku sipas marrëveshjes pronari i truallit do të përfitojë në apartamente banimi sipërfaqen prej 1440 m², në garazhe sipërfaqen prej 200 m² dhe në ambiente shërbimi sipërfaqen prej 200 m².

Me aktet "Per leje shehs ndertimi" dhe Leje ndertimi" rezulton e provuar se KRRT-ja e Bashkisë Vlorë, lidhur me truallin e ndodhur në lagjen "24 Maji", me pronare trualli Aneta Rrapaj, me vendimin nr.5/71, datë 17.08.2010, ka miratuar shesh ndërtimi për një godinë banimi dhe shërbime 6-8-10 kate, me një kat parkim nëntokë. Ndërsa, me vendimin nr.7/69, datë 07.09.2010 KRRT-ja e Bashkisë Vlorë, lidhur me truallin e mësipërm ka miratuar lejën e ndërtimit në favor të subjektit ndërtues "M&G" sh.p.k. Leja e ndërtimit është miratuar në emër këtij subjekti ndërtues, ndërsa sipas marrëveshjes së datës 09.11.2010, ndërtimi do të kryhej nga shoqëria "M&G" sh.p.k në bashkëpunim edhe me shoqërinë "Bakaj" sh.p.k.

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se shtetasi Sokol Bakaj, administrator i shoqërisë "Bakaj" sh.p.k, për lidhjen e marrëveshjes së mësipërme, ka biseduar me të pandehurin Mihail Rrapaj dhe shtetasen e Aneta Rrapaj, me të cilët kanë rënë dakort që të kryenin investimin për kryerjen e ndërtimit dhe se i pandehuri

Mihail Rrapaj dhe bashkëshortja e tij si pjesë takuese do të përfitonin nga kryerja e ndërtimit pjesën takuese prej 25 %.

I pandehuri Mihail Rrapaj, sipas dëshmisë së shtetasit Sokol Bakaj, ka rezultuar se ka qënë i pranishëm në zyrën e noterit në momentin e lidhjes së kontratës së investimit, së bashku me bashkëshorten e tij Aneta Rrapaj.

Ne keto rrethana provohet se i pandehuri Mikail Rrapaj ka kryer veprime aktive për realizimin e marreveshjes me subjektin ndertues për venien në dispozicion të një sipërfaqe trualli të përfituar me të ardhura të siguruar nga shitja e pronave në emër të Kate Rrapaj, prona të përfituara me dokumenta të falsifikuar.

III. Nga provat shkresore që lidhen me origjinën dhe rregjistrimin e pasurisë së paluajtshme me **nr.19/169, zona kadastrale nr.8604**, rezulton e provuar se kjo pasuri është rregjistruar në Z.Rr.P.P Vlorë fillimisht në emër të dy bashkëpronarëve Mikel Anastasiadhi dhe Jorgji Anastasiadhi, mbi bazën e Vendimit Nr.75 datë 21.03.1995 të K.K.K.P, Vlorë, që bën fjalë për subjektin e shpronësuar trashëgimlënesin Minella Anastasiadhi.

Shtetasi Agim Allushi, i afërm i të pandehurit Mihail Rrapaj, (i cili i ka shitur truallin në fjalë shtetases Aneta Rrapaj), e ka fituar pronësinë lidhur me këtë sipërfaqe trualli mbi bazën e kontratës së shitjes nr.2500 Rep, nr.9491 Kol, të datës 24.06.2009, të lidhur midis Agim Allushit dhe shitësve Jorgji Anastasiadhi dhe Mikel Anastasiadhi, të cilët në këtë kontratë janë përfaqësuar nga e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi, të pajisur me prokurë të posacme nga secili prej tyre.

Konkretisht, me prokurën nr.360 Rep dhe nr.223 Kol, datë 13.02.2008, e lidhur në zyrën e Noteres Luljeta Cenaj, sipas të cilës shtetasi Jorgji Anastasiadhi ka emëruar si përfaqësues të tij të pandehurën Xhuljeta Anastasiadhi, si dhe prokurën me nr.463 Rep dhe nr.309 Kol, datë 10.03.2008, e lidhur në zyrën e Noteres Mirela Gjonca, sipas të cilës shtetasi Mikel Anastasiadhi ka emëruar si përfaqësues të tij të pandehurën Xhuljeta Anastasiadhi. Bashkëngjitur praktikës së prokurave të mësipërme ndodhet edhe kopje e pasaportës së të pandehurës Xhulejta Anastasiadhi.

Ndërkohë, nga verifikimet e kryera në sistemin tims ka rezultuar se shtetasi Jorgji Anastasiadhi ka dalë nga Shqipëria për në Itali që në datën 05.02.2008,

pra tetë ditë para datës së të nënshkruhej prokura, si dhe nuk rezulton që të jetë kthyer në Shqipëri. Ai ka vdekur në Itali për shkak të sëmundjes së tij më datë 22.04.2008, pra para lidhjes së kontratës së datës 24.06.2009.

Nga vetë shpjegimet e të pandehurës Xhuljeta Anastasiadhi në seancë gjyqësore rezultoi e provuar se kjo e pandehur ka pasur plotësisht dijeni lidhur me faktin që Jorgji Anastasiadhi është larguar në Itali në datën 05.02.2008, se ka vdekur në Itali në datën 22.04.2008 dhe se në ditën e nënshkrimit të kontratës së shitjes Jorgji Anastasiadhi kishte vdekur.

E pandehura Xhuljeta Anastasiadhi ka qënë bashkëshortja e shtetasit Mikel Anastasiadhi, i cili ka vdekur gjithashtu më datë 10.11.2011, ndërsa shtetasi Jorgji Anastasiadhi ka qënë vëllai i shtetasit Mikel Anastasiadhi.

Është administruar dosja përkatëse e vendimit të komisionit në fjalë nga Agjensia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Tiranë. Janë verifikuar të dhënat e dokumentave të ndodhura në këtë dosje.

Me Akt ekspertimi tekniko grafik Nr.3097, datë 21.03.2013 të Drejtorisë së Policisë Shkencore ka rezultuar se:

- Në vendimin me nr.75 datë 21.03.1995 të K.K.K.P, Vlorë, konstatohen ndryshime në partinë e letrës së përdorur, ngjyrën, llojin e makinës me të cilën janë daktilografuar tekstet, duke u krahasuar me vendime të tjera të së njëjtës periudhë;
- Nënshkrimet e shtetasve Rrapi Hoxha, Hektor Meci, Manol Mertiri, Refie Patosi, Gjon Gavani, Dëshpërime Mustafaj, që janë nënshkrimet e anëtarëve të komisionit që gjenden në vendimin në fjalë, nuk janë nënshkrime origjinale duke u krahasuar me nënshkrimet e këtyre shtetasve në vendime të tjera të marrë nga A.K.K.Pronave Tiranë; Sipas aktit të ekspertimit nënshkrimet e këtyre shtetasve janë të falsifikuara, duke përdorur si metodë imitimin.
- Vula e ndodhur në vendimin e mësipërm është e falsifikuar duke u vizatuar me dorë me mjet shkruar me bojë blu.

Nga akti i ekspertimit të mësipërm rezulton gjithashtu se prokura e lëshuar në emër të shtetasit Jorgji Anastasiadhi, me nr.360 Rep dhe nr.223 Kol e datës 13.02.2008, e nënshkruar para Noterit Luljeta Cenaj, është e falsifikuar dhe

është nënshkruar nga shtetasi Mikel Anastasiadhi, i cili sic dhe shpjeguar më sipër ka vdekur më datë 10.11.2011. Në dokumentacionin e ndodhur në zyrën e noteres është konstatuar një certifikatë lindje, fotokopje, në emër të Jorgji Anastasiadhi, me fotografi që nga shpjegimet e personave që kanë dijeni për hetimin, madje edhe nga shtetasi Samuel Rrapaj, i përket Mikel Anastasiadhit. Duke marrë në konsideratë këtë fakt si dhe konkluzionin e aktit të ekspertimit rezulton se në zyrën e noteres Luljeta Cenaj është paraqitur me dokumentin certifikatë lindje me gjeneralitetet e Jorgji Anastasiadhi, por me fotografi të vet, shtetasi Mikel Anastasiadhi. E pandehura Xhuljeta Anastasiadhi ka qene ne dijeni te plote se Jorgji Anastasiadhi ka qene jashte shtetit per kurim dhe kishte vdekur, pra faktin qe prokura ishte e fallsifikuar dshe e ka perdorur kete prokure.

Më pas e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi ka nënshkruar kontratën me nr.2500 Rep dhe nr.9491 Kol të datës 24.06.2009, si përfaqësuesja e Jorgji Anastasiadhi dhe Mikel Anastasiadhi, duke ia shitur këtë pasuri shtetasit Agim Allushi. Rezulton gjithashtu se kjo shtetase ka nënshkruar edhe aplikimin për rregjistrimin e pronës në fjalë në zyrën e rregjistrimit.

E pyetur lidhur me rrethanat e mësipërme e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi shpjegoi në seancë gjyqësore se bashkëshorti i saj ka pasur njohje me Mihail Rrapaj dhe ata kanë bërë një bisedë që Mihaili ti ndihmonte që të ndryshonin pronën e njohur ish pronarit Minella Anastasiadhi, nga vëndndodhja e saj në lagjen "Lef Sallata", në lagjen "24 Maji", Vlorë.

Për këtë ndihmë kanë rënë dakort që i pandehuri Mikail Rrapaj të bëhej bashkëpronar lidhur me pasurinë që do të rregjistrohej. Kjo shtetase nuk ka pranuar se ka nënshkruar kontratën e shitjes para Noteres Luljeta Cenaj, por shpjegoi se i pandehuri Mihail Rrapaj i ka marrë nënshkrimin në një letër të bardhë, duke i thënë se i duhej për pronat dhe se ishte përfaqësuese e Mikel dhe Jorgji Anastasiadhit.

Gjatë kontrollit të kryer në banesën e të pandehurit Mihail Rrapaj është gjetur në këtë banesë një kopje e vendimit nr.75 datë 21.03.1995 të K.K.K.P, Vlorë, për subjektin Minella Anastasiadhi, që ndryshon në formë dhe përmbajtje me vendimin nr.75 datë 21.03.1995 të K.K.K.P, Vlorë, të administruar nga A.K.K.P

Tiranë. Konkretisht, vendimi i administruar nga A.K.K.P është i nënshkruar nga gjashtë persona në cilësinë e anëtarëve të komisionit, në dispozitivin e tij bën fjalë për kthimin e sipërfaqes prej 2185 m² të ndodhur në lagjen "24 Maji" dhe përshkruan edhe kufitarët.

Ndërsa, sipas kopjes së vendimit të komisionit të gjetur në banesën e të pandehurit Mihail Rrapaj, që mban të njëjtin numër, datë dhe të njëjtin numër dosje, mban nënshkrimin e vetëm të kryetarit të komisionit, sipas dispozitivit të tij ish pronarit Minella Anastasiadhi i njihet pronësia për një truall me sipërfaqe 2185 m² të ndodhur në lagjen "Lef Sallata", kufitarët janë të ndryshëm nga ato të vendimit të mësipërm, si dhe përshkruhet në vendim se subjektit i kthehet në natyrë sipërfaqja prej 380 m² truall e ndodhur në lagjen "Lef Sallata".

Kjo rrethanë, duke u vlerësuar në lidhje me shpjegimet e të pandehurës Xhuljeta Anastasiadhi si dhe me aktet e tjera provon plotësisht dhe tej cdo dyshimi faktin se i pandehuri Mihail Rrapaj ka qënë plotësisht në dijeni të faktit së vendimi i mësipërm është i falsifikuar. Ky vendim nuk provohet te jete perdorur nga i pandehuri Mikail Rrapaj dhe per kete shkak organi i akuzes nuk ka ngritur ndaj tij akuzen per vepren penale te perdorimit te dokumentave te fallsifikuara. Por dijenia per kete fakt dhe veprimet e te pandehurit per blerjen e kesaj pasurie dhe trnsaksionin me subjektin ndertues verteton se i pandehuri ka kryer veprime qe perbejne vepren penale te "Pastrimit te produktevee te vepres penale te parashikuar nga neni 278/1 te K.Penal.

Pikërisht është kjo pasuri e cila e shitur nga e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi si përfaqësuese e shtetasve Mikel dhe Jorgji Anastasiadhi, nëpërmjet transaksionit të kryer me shtetasin Agim Allushi, i afërm i të pandehurit Mihail Rrapaj, ka kaluar në pronësi të shtetasës Aneta Rrapaj, bashkëshortes së të pandehurit Mikail Rrapaj, duke përshkruar në kontratën e shitjes një cmim sa pothuajse gjysma e atij që shtetasi Agim Allushi e ka blerë nga e pandehura Xhulejeta Anastasiadhi.

Nga ana tjetër, rezulton se e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi më datë 01.06.2009 ka bërë aplikimin në Z.Rr.P.P Vlorë për rregjistrimin e pasurisë sipas vendimit nr.75 datë 21.03.1995 të K.K.K.P, Vlorë. Nga Z.Rr.P.P Vlorë është celur dosja në emër të Xhuljeta Anastasiadhi, me numër refence 006741,

ku është depozituar gjithashtu vendimi nr.75 datë 21.03.1995, si dhe prokura e përgjithshme lëshuar në emër të saj nga Jorgji Anastasiadhi, prokure qe rezulton te jete e fallsifikuar per nga rrethanat e trajtuara me siper.

Në këto kushte, rezulton se i pandehuri Mihail Rrapaj ka kryer veprën penale "pastrimi i produkteve te veprës penale" të parashikuar nga neni 287/1, pikat (a), (b) dhe (dh) të K.Penal, (sipas përmbajtjes së saj para ndryshimeve të ligjit nr.23/2012), ndërsa e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi se ka kryer veprën penale "falsifikimi i dokumentave", të kryer më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal.

Rrethanat e faktit penal te pershkruara me siper provohen plotesisht nga teresia e provave te shqyrtuara ne gjykim, me deshmite e deshmitareve dhe shqyrtimin e provave shkresore dhe me konkretisht:

- **Dëshmitarja Kate Rrapaj**, e cila ka kryer edhe kallëzim penal në rastin konkret, pavarësisht faktit se ajo pretendon se dokumentacioni i pronësisë nuk është i falsifikuar, shpjegoi përpara Gjykatës se i pandehuri Mihail Rrapaj është djali i saj, se ky i pandehur në bashkëpunim me persona të tjerë, ka shitur pasurinë e llojit kullotë me sipërfaqe 10 ha, duke i marrë nënshkrimin e saj nëpërmjet gënjeshtërisë, se i pandehuri Mihail Rrapaj e ka cuar tek zyra e noteres Luljeta Cenaj ku ka nënshkruar kontratat e shitjes, duke menduar që po nënshkruante dokumenta të pensionit të sa, se lidhur me pasurinë e shitur nuk ka pasur ndonjë dokument, se nuk ka përfituar ndonjë shumë të hollash nga shitja, se dokumentat i ka nënshkruar në automjetin e djalit të saj, të pandehurit Mihail Rrapaj.
- **Dëshmitari Sokol Bakaj** shpjegoi përpara Gjykatës se, në cilësinë e administratorit të shoqërisë "Bakaj" sh.p.k ka nënshkruar kontratën e investimit me shtetasen Aneta Rrapaj, në zyrën e noterit në momentin e lidhjes së kontratës ka qënë edhe i pandehuri Mihail Rrapaj, sipas kontratës së investimit pala që investonte truallin në këtë sipërmarrje, që

janë bashkëshortët Mihail Rrapaj dhe Aneta Rrapaj, do të përfitonin 25 % të sipërfaqes së ndërtimit që do të kryhej.

- **Dëshmitari Adila Kojdheli** shpjegoi para Gjykatës se në cilësinë e Kryetarit të Komunës Shushicë, ka lëshuar vërtetimin me nr.184, datë 28.12.2008, në emër të Kate Rrapaj, të cilën njëk e njuh, shpjegoi se ja kerkoi një person me emrin Mika.

Kjo dëshmi u kundërshtua pjesërisht nga Prokurori në seancë gjyqësore dhe thëniet e dëshmitarit të kryera gjatë hetimeve paraprake, ku ka shpjeguar se për piketimin dhe për kthimin në natyrë të pasurisë me sipërfaqe 10 ha, për të cilën bën fjalë vërtetimi i nënshkruar prej tij, është interesuar shtetasi Mika Rrapaj.

Kundërshtimi i dëshmisë në këtë rast vlerësohet si provë nga Gjykata, pasi lidhet me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre, sic janë dokumentat e gjetura në banesën e të pandehurit Mihail Rrapaj si dhe më dëshminë e shtetasit Manol Mërtiri.

- **Dëshmitari Manol Mërtiri**, shpjegoi përpara Gjykatës se, ushtron profesionin e topografit, se në vitin 2006 ka përgatitur një plan rievimi për një pronë të ndodhur në fshatin Bunavi, Vlorë, plan rievimi që ndodhet në dosjen e kësaj pasurie, të cilin ia ka kërkuar i pandehuri Mihail Rrapaj, me të cilin ka njohje të mëparshme. Në planin e rievimit ka shkruar emrin e Kate Rrapaj, pasi një gjë të tillë ia ka kërkuar vetë i pandehuri Mihail Rrapaj.

- **Dëshmitari Agim Allushi** shpjegoi para Gjykatës se pasurinë e paluajtshme që e ka blerë nga shtetasja Xhuljeta Anastasiadhi, i ka shitur shtetases Aneta Rrapaj, për këtë shitje ka biseduar me të pandehurin Mihail Rrapaj, me të cilin ka lidhje gjinie, dhe se cmimin e blerjes së kësaj pasurie e ka marrë nga shtetasja Aneta Rrapaj.

- **E-pandehura Xhuljeta Anastasiadhi** shpjegoi përpara Gjykatës se, ka njohje me të pandehurin Mihail Rrapaj, se ky i fundit në vitin 2005 iu ka thënë të pandehurës dhe bashkëshortit të saj, Mikel Anastasiadhit, se do ti

ndihmonte për të marrë pronat e familjes së tyre, duke kërkuar njëkohësisht që të bëhej bashkëpronar në këto pasuri. E pandehura shpjegoi se Mikel Anastasiadhi kishte një vendim të kthimit të pronave, për një sipërfaqe prej 2185 m², nga e cila ishte kthyer vetëm 280 m², se prona e njohur me këtë vendim ndodhej tek vëndi i quajtur Orizi, ndërsa i pandehuri Mihail Rrapaj ka premtuar se do ta rregullonte që të kthente këtë pronë në një vënd tjetër, në lagjen "24 Maji", Vlorë.

E pandehura shpjegoi më pas se prona në lagjen 24 Maji ishte rregjistruar në emër të Jorgji dhe Mikel Anastasiadhi dhe se ishte shitur tek Aneta Rrapaj, bashkëshortja e të pandehurit Mihail Rrapaj.

Gjithashtu, e pandehura shpjegoi se Jorgji Anastasiadhi ka vdekur në muajin mars 2008, në Itali.

- **Nga shkresat** me nr.1754/1 prot dt.27.06.2012, nr.3243/1 prot dt.05.10.2012, nr.2007/1 prot dt.03.08.2012, të A.K.K.P Tiranë, si dhe dokumentacioni ndodhur bashkëngjitur këtyre shkresave, si dhe nga akti i ekspertimit teknik dokumenti i datës 05.11.2012, rezulton tërësisht e provuar se vendimi nr.298 datë 15.10.1996 të ish- K.K.K.P Vlorë, në bazë të të cilit janë rregjistruar në emër të shtetases Kate Rrapaj, pasuritë me nr.410/3, zona kadastrale nr.2142 si dhe nr.410/5, zona kadastrale nr.1316, është një vendim tërësisht i falsifikuar dhe me përmbajtje të rreme.
- **Nga akti i ekspertimit nr.3097**, datë 21.03.2013 të Drejtorisë së Policisë Shkencore rezulton se vendimi me nr.75 datë 21.03.1995 i lëshuar në emër të K.K.K.P, Vlorë, është i falsifikuar, ka ndryshime lidhur me letrën duke u krahasuar me vendime të tjera, nënshkrimet e anëtarëve të komisionit janë të falsifikuara duke përdorur si metodë imitimin, si dhe vula e ndodhur në vendimin e mësipërm është e falsifikuar duke u vizatuar me dorë me mjet shkruar me bojë blu.

Po sipas këtij akti ekspertimi rezulton se kontrata e shitjes nr.2500 Rep dhe nr.9491 Kol të datës 24.06.2009 është nënshkruar nga e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi dhe se kjo shtetase ka nënshkruar edhe aplikimin për rregjistrimin e pronës në fjalë në zyrën e rregjistrimit, duke përdorur në Z.Rr.P.P Vlorë dokumentat me përmbajtje të falsifikuar.

- Nga proces verbali i kontrollit të banesës së të pandehurit Mihail Rrapaj, ka rezultuar se në banesën e tij janë gjetur dhe sekuestruar këto dokumente të paraqitura në këtë gjykim si dokumente provë materiale:
 1. Aplikimi në Z.Rr.P.P Vlorë në emër të Kate Rrapaj, datë 18.04.2005;
 2. Dokumenti vendim nr.298, datë 16.10.1996, në emër të ish K.K.K.P Vlorë, me përmbajtje të falsifikuar;
 3. Vërtetim i Komunës Shushicë Vlorë, nr.184 prot dt.28.12.2009;
 4. Plane rilevimi dhe planvendosje te sipërfaqe 10 ha kullotë, të ndodhur në fshatin Bunavi, Vlorë;
 5. Dy vërtetime hipotekore origjinale, në emër të Kate Rrapaj, me nr.50, datë 20.05.2005 të Z.Rr.P.P Vlorë;
 6. Fotokopje e pasaportës së Kate Rrapaj, si ajo që iu është bashkëngjitur kontratave të shitjes së sipërfaqes 10 ha kullotë tek shtetasi Dhimitër Kondakciu;
 7. Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë me nr.27/120, zona kadastrale nr.8603, për truallin në pronësi të Jorgji Anastasiadhi dhe Mikel Anastasiadhi, për një sipërfaqe trualli 45 m², të ndodhur në lagjen “Lef Sallata”, Vlorë;
 8. Vendim me nr.75, datë 21.03.1995 të ish K.K.K.P Vlorë, nga përmbajtja e e të cilit është njohur pronësia e subjektit Minella Anastasiadhi, të një sipërfaqe prej 2185 m², të ndodhur në lagjen “Lef Sallata”, Vlorë, si dhe është kthyer vetëm sipërfaqeja prej 380 m².
 9. Ky vendim ka të njëjtin numër dhe të njëjtën datë me vendimin e falsifikuar mbi bazën e të cilit është rregjistruar pasuria e paluajtshme me nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, me sipërfaqe 2185 m², e cila është rregjistruar në pronësi të Aneta Rrapaj, por pasuria e rregjistruar nuk ndodhet në lagjen “Lef Sallata”, por në lagjen “24 Maji”, Vlorë;

- Duke vlerësuar vlerën provuese të dokumentacionit të pronësisë së kullotës prej 10 ha të ndodhur në fshatin Bunavi, Vlorë, dokumentacion i cili është gjetur në banesën e të pandehurit Mihail Rrapaj, si dhe aplikimin për në Z.Rr.P.P Vlorë, vërtetimet origjinale hipotekore të kësaj pasurie, kopjen e pasaportës së vjetër të Kate Rrapaj si ajo që i është bashkëngjitur kontratave të shitjes, të gjetura edhe këto në banesën e të pandehurit, duke vlerësuar konkluzionin e aktit të ekspertimit tekniko grafik nr.3097, datë 21.03.2013 të Drejtorisë së Policisë Shkencore, sipas të cilit shtetasja Kate Rrapaj nuk ka nënshkruar aplikimin në emër të saj në Z.Rr.P.P Vlorë, duke vlerësuar faktin se shtetasja Kate Rrapaj ka paraqitur kallëzim penal ndër të tjera edhe ndaj të pandehurit Mihail Rrapaj se e

ka mashtruar në shitjen e kësaj pasurie, duke vlerësuar dëshminë e kallëzueses Kate Rrapaj në seancë gjyqësore, duke marrë në konsideratë dëshmitë e shtetasve Manol Mërtiri dhe Adila Kojdheli, duke vlerësuar në tërësi rrethanat e këtij procedimi penal, si dhe duke i vlerësuar këtë prova në harmoni dhe në lidhje llogjike me njëra tjetrën, provohet plotësisht se i pandehuri Mihail Rrapaj, ka rregjistruar në Z.Rr.P.P Vlorë pasurinë e paluajtshme prej 10 ha kullorë në emër të Kate Rrapaj me dokumenta të falsifikuara, ka disponuar dokumentat e pronësisë lidhur me këtë pasuri, ka tjetërsuar tek shtetasi Dhimitër Kondakciu këtë pasuri të paluajtshme kundrejt cmimit të përshkruar në këtë kontratë, duke ditur që po tjetërsonte një pasuri të përfituar me anë të dokumentave të falsifikuara, si dhe duke ditur që po përfitonte nga shitja e një pasurie produkt të veprës penale, përfitim të cilin gjithashtu e ka përdorur për të blerë pasurinë e paluajtshme me nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, me sipërfaqe 2185 m2, me gjysmën e cmimit të saj real.

- Duke vlerësuar konkluzionet e aktit të ekspertimit nr.3097, datë 21.03.2013 të Drejtorisë së Policisë Shkencore, duke vlerësuar faktin se në banesën e të pandehurit është gjetur vendimi nr.75, datë 21.03.1995 të ish K.K.K.P Vlorë, nga përmbajtja e të cilit është njohur pronësia e subjektit Minella Anastasiadhi, të një sipërfaqe prej 2185 m2, të ndodhur në lagjen "Lef Sallata", Vlorë, si dhe është kthyer vetëm sipërfaqeja prej 380 m2 dhe se ky vendim ka të njëjtin numër dhe të njëjtën datë me vendimin e falsifikuar mbi bazën e të cilit është rregjistruar pasuria e paluajtshme me nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, me sipërfaqe 2185 m2, e cila është rregjistruar në pronësi të Aneta Rrapaj, por pasuria e rregjistruar nuk ndodhet në lagjen "Lef Sallata", por në lagjen "24 Maji", Vlorë, duke vlerësuar edhe shpjegimet e bëra në seancë gjyqësore nga e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi, sipas të cilës i pandehuri Mihail Rrapaj do ti ndihmonte duke rregulluar që prona e njohur subjektit Minella Anastasiadhi në lagjen "Lef Sallata", ti kthehej në lagjen "24 Maji", duke vlerësuar në tërësi rrethanat e këtij procedimi penal, provohet plotësisht se, i pandehuri Mihail Rrapaj nëpërmjet bashkëshortes së tij Aneta Rrapaj (ku cdo pasuri është pjesë e bashkëpronësisë martesore) ka përfituar pasurinë nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, me sipërfaqe 2185 m2, duke e blerë këtë pasuri me gjysmën e vlerës së saj reale, duke e ditur plotësisht se kjo pasuri është produkt i veprës penale të

falsifikimit të dokumentave, dhe më tej po nëpërmjet shtetases Aneta Rrapaj e ka investuar këtë pasuri në veprimtari ekonomike, duke lidhur kontratën e investimit me shoqëritë ndërtuese, me qëllim investimin e truallit për të përfituar 25 % të sipërfaqes së ndërtimit të objektit që do të ndërtohej.

- Gjithashtu, duke vlerësuar konkluzionet e aktit të ekspertimit nr.3097, datë 21.03.2013 të Drejtorisë së Policisë Shkencore, shpjegimet e dhëna nga vetë e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi në seancë gjyqësore, provohet plotësisht se kjo e pandehur ka përdorur dokumente të falsifikuara në Z.Rr.P.P Vlorë për rregjistrimin e pasurisë me nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, me sipërfaqe 2185 m², dhe se ka përdorur prokurën e falsifikuar në emër të Jorgji Anastasiadhi, në momentin kur ka lidhur kontratën e shitjes me shtetasin Agim Allushi për shitjen e pasurisë së mësipërme, duke ditur që kjo e pandehur nuk ka marrë ndonjë prokurë nga ky person dhe për më tepër duke ditur që në momentin e përdorimit të prokurës Jorgji Anastasiadhi kishte vdekur.

Rrethanat e mesiperme u provuan ne gjykim me:

1. Dëshmitë e dëshmitarëve të pyetur gjatë shqyrtimit gjyqësor;
2. Deklarimet e bëra nga e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi në seancë gjyqësore.
3. Shkresat nr.2604/1 prot dt.08.05.2012, nr.5980 prot dt.07.09.2012, të Z.Rr.P.P Vlorë, si dhe dokumentacioni ndodhur bashkëngjitur këtyre shkresave;
4. Shkresat nr.1754/1 prot dt.27.06.2012, nr.3243/1 prot dt.05.10.2012, nr.2007/1 prot dt.03.08.2012, të A.K.K.P Tiranë, si dhe dokumentacioni ndodhur bashkëngjitur këtyre shkresave;
5. Proces verbal për këqyrjen e dokumentave datë 18.07.2012, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur këtij proces verbal;
6. Proces verbal për sekestrimi e dokumentave datë 17.07.2012, si dhe dokumentacioni i sekustruar dhe që është përshkruar në këtë proces verbal;
7. Akt ekspertimi teknik dokumenti i datës 05.11.2012;
8. Shkresë nr.6116/1 prot dt.17.09.2012 i Z.Rr.P.P Vlorë, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur;

9. Proces verbalet për këqyrjen e dokumentave datë 26.09.2012, 30.10.2012, 19.03.2013, 04.12.2012, 04.04.2013, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur këtyre proces verbaleve;
10. Shkresë nr.3244/1 prot dt.07.09.2012 e A.K.K.P Tiranë, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur kësaj shkresë;
11. Shkresë nr.2276 prot dt.18.09.2012 e Bashkisë Vlorë, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur;
12. Proces verbal për këqyrjen e të dhënave të sistemit tims për shtetasin Jorgji Anastasiadhi, datë 24.05.2013;
13. Proces verbalet për sekuestrimin e dokumentave, datë 31.10.2012, datë 04.12.2012, datë 30.10.2012, datë 27.02.2013, si dhe dokumentacioni i sekuestruar i përshkruar në proces verbalet përkatëse;
14. Akt ekspertimi grafik shkrimi, nënshkrimi, teknik vule e teknik dokumenti, me nr.3097, datë 21.03.2013 i Drejtorisë së Policisë Shkencore, Tiranë;
15. Proces verbal për kontrollin e banesës datë 24.05.2013;
16. Proces verbal për sekuestrimin e dokumentave në banesën e të pandehurit Mihail Rrapaj, datë 24.05.2013, si dhe dokumentacioni i sekuestruar dhe i përshkruar në proces verbalin përkatës.
17. Aktet e tjera shkresore të ndodhura dhe të bashkëngjitura në fashikullin gjyqësor.

Mbi rrethanat e mesiperme dhe percaktimin e ligjit gjykata vlereson se:

I - Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se i **pandehuri Mihail Rrapaj**, nëpërmjet kryerjes së veprimeve të tij që konsistojnë në shitjen dhe transferimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme me nr.410/5, zona kadastrale nr.1316, si dhe nr.410/3, zona kadastrale nr.2142, të cilat janë produkt i veprës penale të falsifikimit dhe përdorimit të dokumentave të falsifikuar, si dhe duke vijuar më tej në përdorimin e parave të rrjedhura nga këto pasuri për blerjen e pasurisë me nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, ku edhe kjo pasuri në vetvete është produkt i veprës penale të falsifikimit të dokumentave, fakt për të cilin i pandehuri ka pasur tërësisht dijeni dhe transferimet e kësaj pasurie janë kryer mbi bazën e dokumentave të falsifikuar, duke fshehur dhe mbuluar kështu origjinën e kundraligjshme të

këtyre pasurive dhe të të hollave të rrjedhura prej tyre, si dhe në përdorimin e sipërfaqes së truallit për kryeje të veprimtarisë ekonomike, duke lidhur kontratën e investimin-sipërmarrjes për ndërtim pallati ku është parashikuar që pronarët e truallit të përfitojnë pjesë takuese nga kryerja e këtij ndërtimi, ka konsumuar tëërsisht të gjithë elementët e veprës penale "pastrimi i produkteve te veprës penale" të parashikuar nga neni 287/1, pikat (a), (b) dhe (dh) të K.Penal, sipas përmbajtjes së saj para ndryshimeve të ligjit nr.23/2012.

Veprimet e mësipërme i pandehuri Mihail Rrapaj i ka kryer edhe nëpërmjet shtetases Kate Rrapaj dhe bashkëshortes së tij Aneta Rrapaj, por nuk rezulton që këto shtetase të kenë pasur dijeni lidhur me faktin se pasuritë e mësipërme kanë qënë produkte të veprës penale.

Neni 287/1 K.Penal percakton: "*1.Pastrimi I produkteve te vepres penale I kryer nepermjet: a)kembimit apo fshehjes se pasurise, me qellim fshehjen ose mbulimin e origjines se paligjshme te saj, duke ditur se kjo pasuri eshte product I vepres penale ose I veprimtarise kriminale; b)fshehjes ose mbulimit te natyres se vertete, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronesise ose te drejtave ne lidhje me pasurine, duke ditur qe kjo pasuri eshte product I vepres penale ose I veprimtarise kriminale;... dh) perdorimit dhe investimit ne veprimtari ekonomike ose financiare te parave ose sendeve, qe jane produkte te vepres penale, denohen nga tre deri ne dhjete vjet"*

Veprimet e te pandehurit Mikail Rrapaj kane patur per **object** dhe kane cenuar marredheniet juridike te vendosura nga shteti per te siguruar interesat shteterore dhe publike nga veprime te kundraligjshme te tjetersimit te pasurise se perfituar ne menyre kriminale dhe te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni penal.

-**Nga ana objective** i pandehuri I ka kryer keto veprime ne menyre direkte duke patur dijeni se prona ishte perftuar ne menyre te kundraligjshme, ka kryer transakcione per shitjen dhe riblerjen e saj, e ka tjetersuar ate me veprime te kontraktimit per ndertim me subjektin ndertues dhe me qellim perfitimin e siperfaqeve te ndertimit nga ana e subjectit investues, duke tjetersuar produktin (truallia) e perfituar nepermjet vepres penale te "fallsifikimit", ne siperfaqe ndertimore me qellim tjetersimin e tyre te metejshem ne transakcione financiare.

-I pandehuri si subject i vepres penale eshte madhor dhe plotesisht pergjegjshme para ligjit.

-**Nga ana subjective** i pandehuri keto veprime I ka kryer me dashje dhe me qellimin perfitimi pasuror.

Ne keto rrethana gjykata konkludon se i pandehuri Mikail Rrapaj ka konsumuar teresisht elementet e vepres penale te te "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga neni 287/1 pikat (a), (b) dhe (dh) te K.Penal dhe duhet te deklarohet fajtor.

- Ne lidhje me caktimin e denimit ndaj te pandehurit Mikail Rrapaj, Gjykata mban parasysh:

Neni 47 K.Pr.Penale percakton:

"Gjykata cakton denimin duke respektuar dispozitat e pjeses se pergjithshme te ketij Kodi dhe kufijte e denimeve te parashikuar ne ligj per vepren penale.

Ne caktimin e denimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmerine e vepres penale, te autorit te saj, shkallen e fajit si dhe rrethanat lehtesuese dhe renduese".

Ne zbatim te kesaj dispozite Gjykata mban parasysh ne caktimin e denimit per vepren penale te kryer nga i pandehuri, kufijte e denimit te parashikuar ne nenin 287/1 te K.Penal, rrezikshmerine e veprese penale dhe te autorit te saj, shkallen e fajit per nga mendimi kriminal dhe veprimet e kryera, si dhe rrethanat lehtesuese dhe renduese, ne vecanti qendrimin e te pandehurit ndaj vepres penale te kryer dhe ndaj procedimit penal ndaj tij.

Nga ana tjeter, Gjykata vlereson se masa e denimit te te pandehurit nuk duhet te jete nje mase represive qe permbush vetem karakterin ndeshkues te denimit penal, por denimi i te pandehurit duhet te individualizohet duke patur parasysh personalitetin dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale, si dhe duhet te jete ne perputhje me parimet e denimit penal. Caktimi i denimit per te pandehurin, por edhe ekzekutimi I tij, duhet te permbush karakterin ndeshkues si dhe duhet ti sherbeje qellimit edukues dhe rehabilitues te te pandehurit.

Qëllimi i dënimit penal përveç ndëshkimit dhe rehabilitimit të autorit të veprës penale përqëndrohet dhe në *frenimin e posacëm dhe të përgjithshëm* në lidhje me kryerjen e veprave penale. Gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit merr parasysh dhe efektin që do të ketë ky dënim si në sjelljen e mëvonshme të te pandehurit ashtu dhe në efektin parandalues të autorëve të krimeve në potencial.

Konkretisht Gjykata mban parasysh:

- Rrezikshmerine e larte te vepres penale me tendencen e perhapjes se saj.
- Faktin qe i pandehuri i eshte shmangur hetimit dhe gjykimit te ceshtjes penale ne ngarkim te tij dhe i fshihet ekzekutimit te mases "arrest ne burg" te caktuar ndaj tij ne kuader te ketij procedimi, kohëzgjatjen e mendimit kriminal tek i pandehuri dhe perseritjen e veprimeve kriminale prej tij cka tregon nje rrezikshmeri te larte te te pandehurit.

- Rrethana te gjendjes familjare, te gjendjes gjyqesore si i padenuar me pare, rrethana lehtesuese te parashikuara nga neni 49 K.Penal,
- Parashikimet e nenit 278/1 te K.Penal mbi masen e denimit
- Vleresimet dhe kerkimet e organit te akuzes.

Ne keto rrethana gjykata vlereson denimin e te pandehurit me burgim. Ne lidhje me masen e denimit me burgim gjykata mban parasysh rrethanat e kryerjes se vepres penale, te rrezikshmerise se larte te vepres dhe te autorit, rrethanat qe lidhen me gjendjen familjare dhe personalitetin e te pandehurit dhe vlereson se masa e denimit me burgim duhet te jete me keto rrethana.

Perfundimisht, gjykata konkludon denimin e te pandehurit me (gjashte) vjet burgim.

II - Ndërsa, e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi ka kryer veprën penale që akuzohet me veprime aktive të kundraligjshme që konsistojnë në përdorimin e dokumentave të falsifikuar në Z.Rr.P.P Vlorë për rregjistrimin e pasurisë nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, në përdorimin në zyrën e Noteres së prokurës së falsifikuar si përfaqësuese e shtetasit Jorgji Anastasiadhi, si dhe në paraqitjen e rrethanave të rreme në kontratën e shitjes me nr.2500 Rep, nr.9491 Kol, të datës 24.06.2009, duke kryer shitjen e kësaj pasurie si përfaqësuese e shtetasit Jorgji Anastasiadhi, pa e patur nje tager te tille dhe me dijenine per mungesen e tagrave te perfaqesimit ne rrethanat e dijenise per vdekjen e te perfaqesuarit para kryerjes se veprimeve.

Neni 186 K.Penal percakton: *“Falsifikimi i dokumenteve
Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet dhe me gjobe nga dyqindmije deri ne gjashteqind mije leke.
Kur kjo veper kryhet ne bashkepunim ose me shume se nje here apo ka sjelle pasoja te renda, denohet me burgim nga gjashte muaj deri ne kater vjet.
Kur fallsifikimi behet nga personi qe ka per detyre te leshoje dokumentin, denohet me*”

Gjykata vlereson se per te patur konsumim te vepres penale te “Fallsifikimit te dokumenteve” duhet te rezultojne dhe provohen rrethana fakti te tilla qe te plotesojne konsumimin e elementeve te vepres penale te parashikuara nga neni 186 te K.Penal.

- **Object I** vepres penale te falsifikimit apo perdorimit te dokumenteve te fallsifikuara, te parashikuara ne nenin 186 te K.Penal, jane marredheniet

juridike te vendosura per te siguruar mbrojtjen e veprimtarise se rregullt shtetore dhe private si dhe te mbrojtjes se interesave te ligjshme te shtetit dhe te shtetasve. Objecti i veprimeve te te pandehures ne rastin konkret kane qene pikerisht keto marredhenie te cenuara nga veprimet e te pandehures.

- **Nga ana objektive** konsumimi i vepres penale konsiston ne kryerjen e veprimeve aktive per fallsifikimin ose perdorimin e dokumentave te fallsifikuara. Ne paragrafin e dyte, nese veprimet e fallsifikimit apo te perdorimit te dokumentit te fallsifikuar kryhen ne bashkepunim, me shume se njehere apo ka sjelle pasoja te renda, perben nje cilesim te posacem te vepres dhe parashikohet masa e denimit sipas ketij paragrafi. Ne rastin konkret veprimet e te pandehures konsistojne ne perdorimin e dokumenteve te fallsifikuara ne ZVRPP Vlore dhe ne perdorimin e nje procure perfaqesimi te fallsifikuar. Veprimet jane kryer ne menyre te perseritur prej te pandehures dhe pasojat e ardhura kane gene te renda.
- E pandehura si **Subjekt I** kesaj vepre penale ploteson te gjitha kriteret ligjore per te mbajtur pergjegjesi penale.
- **Nga ana subjektive** kryerja e veprimeve nga e pandehura eshte bere me ekzistencen e dashjes direkte. Ne kryerjen e kesaj vepre penale dashja direkte evidentohet ne tre forma: *a)* dijenia e personit te ngarkuar me leshimin e dokumentit se ne permbajtjen e aktit po paraqet te dhena te rreme, *b)* deshires per t'i kryer veprimet dhe *c)* kryerjen e veprimeve me qellim fitimi apo ndonje interes tjetër personal.

Ne rrethanat e rastit konkret rezultojne se e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi ka konsumuar plotesisht elemente e vepres penale te "Fallsifikimit te dokumentave" te parashikuar nga neni 186/2 te K.Penal dhe duhet te deklarohet fajtores.

Ne lidhje me caktimin e denimit ndaj te pandehurit Xhuljeta Anastasiadhi, Gjykata mban parasysh:

Neni 47 K.Pr.Penale percakton:

"Gjykata cakton denimin duke respektuar dispozitat e pjeses se pergjithshme te ketij Kodi dhe kufijte e denimeve te parashikuar ne ligj per vepren penale.

Ne caktimin e denimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmerine e vepres penale, te autorit te saj, shkallen e fajit si dhe rrethanat lehtesuese dhe renduese".

Ne zbatim te kesaj dispozite Gjykata mban parasysh ne caktimin e denimit per vepren penale te kryer nga i pandehuri, kufijte e denimit te parashikuar ne nenin 186/2 te K.Penal, rrezikshmerine e veprese penale dhe te autorit te saj, shkallen e fajit per nga mendimi kriminal dhe veprimet e kryera, si dhe rrethanat lehtesuese dhe renduese, ne vecanti qendrimin e te pandehurit ndaj vepres penale te kryer dhe ndaj procedimit penal ndaj tij.

Nga ana tjetere, Gjykata vlereson se masa e denimit te te pandehurit nuk duhet te jete nje mase represive qe permbush vetem karakterin ndeshkues te denimit penal, por denimi i te pandehurit duhet te individualizohet duke patur parasysh personalitetin dhe rrethanat e kryerjes se vepres penale, si dhe duhet te jete ne perputhje me parimet e denimit penal. Caktimi i denimit per te pandehurin, por edhe ekzekutimi i tij, duhet te permbushet karakterin ndeshkues si dhe duhet ti sherbeje qellimit edukues dhe rehabilitues te te pandehurit.

Qëllimi i dënimit penal përveç ndëshkimit dhe rehabilitimit të autorit të veprës penale përqëndrohet dhe në *frenimin e posacëm dhe të përgjithshëm* në lidhje me kryerjen e veprave penale. Gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit merr parasysh dhe efektin që do të ketë ky dënim si në sjelljen e mëvonshme të të pandehurit ashtu dhe në efektin parandalues të autorëve të krimeve në potencial.

Konkretisht Gjykata mban parasysh:

- Rrezikshmerine e larte te vepres penale me tendencen e perhapjes se saj.
- Kohëzgjatjen e menimit kriminal tek e pandehura dhe perseritjen e veprimeve prej saj cka tregon nje rrezikshmeri te larte te te pandehures.
- Rrethana te gjendjes familjare, te moshes se te pandehures, te gjendjes gjyqesore si e padenuar me pare, rrethana lehtesuese te parashikuara nga neni 49 K.Penal,
- Parashikimet e nenit 186/2 te K.Penal mbi masen e denimit.
- Vleresimet dhe kerkimet e organit te akuzes.

Perfundimisht gjykata vlereson denimin e te pandehurit me dy vjet burgim.

Perfundimisht, gjykata duke patur parasysh rrethanat e kryerjes se veprave penale ne teresine e elementeve te konsumuara nga te pandehurit, seicili me veprimet e veta ne rastin konkret, konkludon denimin e te pandehurit Mikail Rrapaj me 6 (gjashte) vjet burgim dhe denimin e te pandehures Xhuljeta Anastasiadhi me dy vjet burgim.

Ne lidhje me dokumentat qe rezultuan te fallsifikuara gjate ketij gjykimi, si prova materiale ne gjykim, gjykata ne baze te nenit 391/1 te K.Pr.Penale, duke vlerësuar se dokumentat e përshkruara më sipër janë të falsifikuara, duhet të deklarojë falsitetin e tyre me qellim heqjen e efekteve juridike te tyre.

Ne lidhje me kerkimin e prokurorit per konfiskimin e produkteve te vepres penale, Gjykata vlereson se, duke qene se provohet plotesisht se pasuritë e paluajtshme në këtë rast janë rregjistruar mbi bazën e dokumentave të falsifikuar, pasi titulli i pronësisë mbi bazën e të cilit janë rregjistruar këto pasuri, Vendimi me Nr.298 datë 15.10.1996 i K.K.K.P, Vlorë, si dhe Vendimi me Nr.75 datë 21.03.1995 të K.K.K.P, Vlorë, janë të falsifikuar, rrjedhimisht dhe pasuritë nr.410/5, zona kadastrale nr.1316, nr.410/3, zona kadastrale nr.2142, si dhe nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, përbëjnë produkte të veprës penale të falsifikimit të dokumentave. Ne zbatim të nenit 30/I/2 të K.Penal keto sende duhet të konfiskohen dhe të kalojnë në pronësi të shtetit.

PER KETO ARSYE

Gjykata në baze të Neneve 379 e vijues e 390 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI

1.- Deklarimin fajtor të të pandehurit Mihail Rrapaj për kryerjen e vepres penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale*" dhe në baze të nenit 287/1, pikat (a), (b) dhe (dh) të K.Penal, (sipas përmbajtjes së saj para ndryshimeve të ligjit nr.23/2012) dhe denimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.

- Vuajtja denimit të filloje nga dita e arrestimit për efekte të ekzekutimit të këtij vendimi dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

2.- Deklarimin fajtor të të pandehurës Xhuljeta Anastasiadhi për kryerjen e vepres penale "*Falsifikimi i dokumentave*", më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda, dhe në baze të nenit 186/2 të K.Penal denimin e saj me 2 (dy) vjet burgim.

- Vuajtja denimit të filloje nga dita e vendosjes nën masën e sigurimit "arrest në shtëpi" dt 27.05.2013 dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

3.- Në bazë të nenit 391/1 të K.Pr.Penale, deklarohen të falsifikuara, duke urdheruar asgjësimin e tyre, dokumentat e sekuestruara të mëposhtme:

1.- Vendimi nr.298 datë 15.10.1996 të ish- K.K.K.P Vlorë, bashkëlidhur planimetria e vendosjes së pronës në emër të këtij komisioni, mbi bazën

e të cilave janë regjistruar pasurite e paluajtshme nr.410/5, zona kadastrale, si dhe ajo me nr.1316 nr.410/3, zona kadastrale nr.2142 si dhe aktet e regjistrimit të këtyre pasurive;

2. Vendim nr.75 datë 21.03.1995 të K.K.K.P, Vlorë, planimetria përkatëse e truallit që shoqëron këtë vendim, mbi bazën e të cilit është regjistruar pasuria e paluajtshme nr.19/169, zona kadastrale nr.8604 si dhe aktet e regjistrimit të kësaj pasurie;
3. Prokurë e përgjithshme nr.360 Rep dhe nr.223 Kol, datë 12.02.2008 në emër të Jorgji Anastasiadhi;
4. Kontratë shitje nr.2500 Rep dhe nr.9491 Kol, datë 24.06.2009, e lidhur midis shtetasve Xhuljeta Anastasiadhi dhe Agim Allushi, për shitjen e pasurisë nr.19/169, zona kadastrale nr.8604.

4.- Në bazë të nenit 36/1/b të Kodit Penal, konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit, duke urdheruar fshirjen e regjistrimeve në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin në favor të shtetit, për si produkte të veprës penale të falsifikimit të dokumentave, të cilat janë nën masën e sigurimit të sekuestros preventive, dhe konkretisht:

- 1- Pasuria me nr.410/5, zona kadastrale nr.1316, e llojit kullotë, me sipërfaqe 87.634 m², e ndodhur në fshatin Bunavi, Komuna Shushicë, Vlorë;
- 2- Pasuria me nr.410/3, zona kadastrale nr.2142, e llojit kullotë, me sipërfaqe 12.366 m², e ndodhur në fshatin Kërkovë, Komuna Qëndër Vlorë;
- 3- Pasuria me nr.19/169, zona kadastrale nr.8604, e llojit truall, me sipërfaqe prej 2.185 m², e ndodhur në lagjen "24 Maji" në Vlorë.


5.- Në bazë të nenit 190/1, gërma (ç) të K.Pr.Penale, dokumentet e tjera të sekuestruara, të përshkruara në urdhërin e Prokurorit datë 17.06.2013 për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor, t'ju kthehen personave që iu janë sekuestruar sipas proces verbaleve përkatëse të sekuestrimit.

-Shpenzimet hetimore dhe gjyqësore u ngarkohen proporcionalisht të pandehurve.


-Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 diteve .
(Per te pandehurin ne mungese afati I ankimit fillon nga dita e komunikimi te ketij vendimi.)

- U shpall ne Vlorë date 08.07.2014.


GJYQTAR
MIRELA MISHGJONI



GJYQTAR
ALBERT SPIRO



GJYQTAR/Kr
ARQILE BASHO




Sekretare
Luljeta Kollombo



Shpenzime gjyqesore

Shpenzime hetimore _____	36.000 leke
Shpenzime kancelarie _____	500 leke
Shpenzime totale _____	36.500 leke

Sekretare
Luljeta Kollombo



Vendimi mori formë të prerë me Vendimin Nr. 67 datë 04.02.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur :

- Lënien në fuqi të vendimit Nr. 366, datë 08.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me plotësimin :
- Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurën Xhuljeta Anastasiadhi për një periudhë prove prej 18 muajsh me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryerje vepër tjetër penale.
- Në zbatim të neneve 59,60 e 61 të K.Penal urdhërohet e pandehura Xhuljeta Anastasiadhi të mbaje kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës Vlorë një herë në tre muaj.

Vlorë me datë 26.02.2015

KANCELARE
Rezarta TAUSHANI

